



REPUBLIKA E MQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZIVE

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1 dhe 10¹ të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), në pajtim me nenin 54 paragrafi (4) dhe neni 104 paragrafi (4) nga Ligji i Procesurës së Përgjithshme Administrative (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.124/15), në lidhje me Propozimin PA1 nr.08-49 datë 14.02.2025 dhe Propozimin PA1 nr.08-49 datë 27.02.2025, në pajtim me Konkluzionin, ark.nr.02-799/9, datë 28.02.2025, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive, në seancën e 9-të mbajtur më 28.02.2025, ka miratuar:

AKTVENDIM
për ndalim të procedurës së inicuar për heqjen
e lejes për transmetim televiziv

NDALOHET procedura e inicuar për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive (SHTR) ALFA TV SHPKNJP Shkup, PA1 nr.08-1 datë 07.09.2023.

A r s y e t i m

Këshilli i Agjencisë për Shërbime Audio dhe Audiovizive (Agjencia) në seancën e 7-të mbajtur më 18.02.2025, me Konkluzion ark.nr.02-657/8 të datës 18.02.2025, miratoi propozimin e dr. Zoran Trajčevski, Drejtor i Agjencisë, PA1 Nr. 08-49 datë 14.02.2025, dhe ka inicuar procedurë për heqjen e lejes për transmetim televiziv të SHTR ALFA TV SHPKNJP Shkup, PA1 Nr.08-1 datë 07.09.2025, për shkak se pas kryerjes së mbikëqyrjes së rregullt administrative, në Raportin me shkrim ark.nr.05-658/1 datë 14.02.2025, është konstatuar se transmetuesi në afatin ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimin të faturës së dhënë nga Agjencia, nuk ka paguar kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv Agjencisë.

Lidhur me këtë, nga Agjencia me datë 19.02.2025, draejtuar transmetuesit në fjalë është dërguar Shkresë PA1 nr.08-49 datë 19.02.2025, për njoftim se nëse nuk paguan kompensim vjetor për transmetim televiziv, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimin të Propozimit për



**Agjenci për shërbime
mediatike audio dhe
audiovizive**

**rr. Maqedonia nr 3 8
1000 Shkup
Republika e
Maqedonisë së Veriut**

tel. + 389 2 3103 400

**www.avmu.org.mk
www.avmu.mk
contact@avmu.mk**



¹ Paragrafët 8 dhe 9 janë fshirë, shih: nenin 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 248/18).



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZIVE

inicimin e procedurës për heqjen e lejes, do të miratohet vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv.

Megjithatë, më 26.02.2025, drejtaur Drejtorit të Agjencisë, nga Sektori për financa dhe logjistikë, është dorëzuar Njoftim ark.nr.05-658/2 datë 26.02.2025 se SHTR ALFA TV SHPKNJP Shkup, më 24.02.2025, ka kryer pagesën në shumë prej 3.329.421,00 (tre milionë e treqind e njëzet e nëntë mijë e katërqind e njëzet e një) denarë dhe më 25.02.2025, ka kryer pagesë në shumë prej 402.603,00 (katërqind e dy mijë e gjashtëqind e tre) denarë, nga ku kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv e ka paguar në tërësi.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1 dhe 10²të LSHMAAV, në pajtim me nenin 54 paragrafi (4) dhe neni 104 paragrafi (4) nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative, në lidhje me Propozimin PA1 nr.08-49 datë 14.02.2025 dhe Propozimin PA1 nr.08-49 datë 27.02.2025 në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-799/9 datë 28.02.2025, Këshilli i Agjencisë, në seancën e 9-të mbajtur më 28.02.2025, vendosi të ndalon procedurën e inicuar për heqjen e lejes.

Bazuar nga sa më sipër u mor aktvendim si në dispozitiv.

Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për inicim të kontestit administrativ para gjykatsn kompetente. Padia për fillimin e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

² Paragrafët 8 dhe 9 janë fshirë, shih: nenin 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 248/18).